



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 32
Prishtinë, më 24.6. 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL
I Mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe
Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Në mbledhje morën pjesë: Fadil Demaku, nënkryetar i parë; Bojan Mitiq, nënkryetar i dytë; Rexhep Selimi, Anton Quni, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami dhe Nuredin Ibishi, anëtarë.

Munguan: Daut Haradinaj dhe Zafir Berisha.

Përfaqësuesit nga Zyra e BE-së në Prishtinë- Nora Fargacs, Urmas Kuk, Njomëza Zejnullahu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Luanda Domi, DCAF; Milot Rexhepi, DCAF; Visar Rushiti, GAP, Agnesa Haxhiu, KDI; Vesë Kelmendi-QKSS.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Fadil Demaku, nënkryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më datë 27.5.2016;
3. Njoftim nga Projekti i BE-së rreth propozim-ndryshimeve të kornizës ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale në Kosovë;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më datë 27.5.2016

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Njoftim nga Projekti i BE-së rreth propozim-ndryshimeve të kornizës ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale në Kosovë

Kryesuesi- Në fillim të fjalës së tij, theksoi se me kërkesë të përfaqësuesve të projektit të BE-së për ndryshimin e kornizës ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, që të paraqesin në Komision propozimet për ndryshimin e kësaj kornize, sot kemi të ftuar përfaqësuesit e këtij projekti. Duke qenë se në Strategjinë Legjislative për vitin 2016, është paraparë që në muajin nëntor të bëhet shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale, konsiderojmë që ofrimi i propozimeve në këtë takim dhe në takimet e radhës, do t'i kontribuonte pozitivisht procesit të shqyrtimit të këtij projektligji. Fjalën ua dha përfaqësuesve të Zyrës së BE-së.

Nora Forgacs- Në fillim të fjalës së saj, theksoi se është këtu për të prezantuar projektin e BE-së për Kosovën, për mbështetjen e institucioneve të Kosovës, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Më tutje, theksoi se ky projekt ka tashmë tre vjet që mbështet Qeverinë, Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe institucionet e tjera që menaxhojnë me të dhënat personale, për të ngritur standardin e mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, theksoi se bashkëpunojnë ngushtë me Qeverinë.

Më tutje, theksoi se sa i përket Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e cila tashmë ka pesë vite që është formuar, ndërsa pesë mbikëqyrësve të emëruar nga Kuvendi i Kosovës, iu ka kaluar mandati më 23 qershor 2016.

Në vazhdim, theksoi se pas punës gati trevjeçare, kanë dalë me disa sugjerime dhe rekomandime dhe janë pesë çështje të cilat do t'i përmendë në këtë takim.

Pas pesë vjetëve të përvojës së Agjencisë, theksoi se në vazhdimësi janë hasur pesë probleme të ndryshme: e para ka të bëjë me strukturën organizative të Agjencisë, e dyta ka të bëjë me shtrirjen e mandatit të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e treta ka të bëjë me disa funksione të Agjencisë, theksoi pushtetin të sanksionojë, e katërta është aspekti i Kodit Penal në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, dhe e pesta, janë sfidat e përshtatjes me direktivat dhe rregulloret e BE-së.

Sa i përket strukturës së Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave, janë pesë mbikëqyrës, me mandat të njëjtë menaxhues, në krye të këtij institucioni. Gjithashtu, ata kanë kompetenca të inspektiveve, si dhe kompetenca në vendimmarrje. Më tutje, theksoi se për të ardhmen e institucionit, kufizimi i numrit të mbikëqyrësve në menaxhimin e këtij institucioni dhe se

preferenca e tyre është një udhëheqës menaxhues, pra ulja e numrit të stafit menaxhues në një komisionar dhe arsyeja për këtë është se kjo është një nga praktikat më të mira evropiane, ndërsa arsyeja e dytë është aspekti menaxherial, duke shmangur problemet e brendshme. Arsyeja tjetër është se Agjencia është e vogël dhe është më pak e kushtueshme.

Ndërsa, sa i përket mandatit të Agjencisë, theksoi se aktualisht Agjencia është përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave dhe se ndryshimet që do të bëhen janë të lehta, për shkak se ekziston baza. Sugjerimi nga ana e tyre është që gjatë kohës kur të bëhet plotësim-ndryshimi i ligjit, të bëhet edhe unifikimi i kompetencës së Agjencisë, për të mbikëqyrur të dhënat personale dhe qasjen në dokumentet publike. Kjo për arsye se është praktikë e mirë evropiane, pasi është më e përshtatshme që të dy këto aspekte, mbrojtja e të dhënave personale dhe qasja në dokumentet publike të jenë në kuadër të një trupi mbikëqyrës. Pra, dy mesazhe të rëndësishme janë: institucioni me një menaxher është i mjaftueshëm dhe vendosja në një institucion e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumentet publike.

Aspekt tjetër i rëndësishëm, i cili është propozuar që të ndryshohet, është edhe fuqia sanksionuese e Agjencisë, ku në raste se ankohet ndonjë person, Agjencia e inspekton këtë rast dhe në rast se Agjencia gjen ndonjë shkelje, janë disa sanksione. Aktualisht, Agjencia nuk ka fuqi për të përcaktuar sanksione, por e procedojnë në gjykatë, procedurë e cila merr kohë dhe nuk arrihet të realizohet misioni i Agjencisë, si duhet. Për këtë arsye, është propozuar që këtë fuqi ta ketë Agjencia. Gjithashtu, është propozuar që edhe në Kodin Penal të bëhen disa ndryshime, që në Kodin Penal të reflektohet mbrojtja e të dhënave personale.

Kryesuesi- Falënderoi për propozimet e ofruara nga ana e znj. Nora Fargacs dhe fjalën ua dha anëtarëve të Komisionit.

Rexhep Selimi- Konsideroi se roli i Komisionit në mbështetjen e punës së Agjencisë, si dhe në kuadër të mbikëqyrjes dhe gjatë ecurisë, është parë që çështja e mbrojtjes së të dhënave personale është një sfidë, pasi edhe në rrafshin global ekzistojnë qasje për të poseduar dhe menaxhuar me të dhënat personale. Duke i falënderuar për kontributin e dhënë nga ana e ekspertëve të Zyrës së BE-së në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe duke theksuar që nga ana e Komisionit do të ofrohet kontributi, me qëllim të avancimit të legjislacionit në këtë fushë dhe se kontributi i ofruar nga ata, do të merret në konsideratë.

Nuredin Ibishi- Duke iu referuar propozimeve të ekspertëve nga projekti i BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale, shtroi pyetjen si vijon: Sa do të marrë kohë që të harmonizohen ligjet që u theksuan (Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligji për qasje në dokumentet publike, si dhe Kodi i Procedurës Penale), a do të ofrohet përkrahja e tyre gjatë procesit të amendamentimit të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale?

Nora Fargacs- Theksoi se sa i përket pjesës profesionale, pjesa më e madhe e punës është bërë, ndërsa sa ai përket se kur do të procedohet, është çështje e Qeverisë së Kosovës dhe se në fillim të shtatorit të vitit 2016, ligji do të silllet në Kuvend për plotësim-ndryshim. Ndërsa, sa i përket mbështetjes nga ana e tyre gjatë procesit të shqyrtimit të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, theksoi se projekti përfundon më herët, por që nga ana e tyre është bërë aplikimi për vazhdimin e tij dhe një letër mbështetëse nga ana e Komisionit do të konsiderohej një ndihmesë.

Bojan Mitiq- Përshëndeti të pranishmit dhe shprehu kënaqësinë për të dëgjuar sugjerimet e dhëna nga përfaqësuesit e këtij projekti. Lidhur me numrin e të punësuarve në Agjenci, theksoi se është i madh. Duke pasur parasysh që mbrojtja e të dhënave personale është e garantuar, shtroi pyetjet si në vijim: Si e vlerësoni, si do të zvogëlohet numri i të punësuarve në këtë Agjenci? A ka pasur sanksione ndaj zyrtarëve të Agjencisë dhe sa është numri i tyre?

Nora Forgacs- Në përgjigjeje të pyetjeve të z. Mitiq, tha se nuk kanë sugjeruar uljen e numrit të të punësuarve, por të ulet numri i stafit menaxhues, ku aktualisht janë pesë zyrtare dhe nga ana e tyre është sugjeruar vetëm një.

Ndërsa, sa i përket numrit të të punësuarve, sugjerimi i tyre që gradualisht të ketë rritje të lehtë të stafit edhe kur çështja e qasjes në dokumente publike do të jetë pjesë e mandatit të këtij institucioni. Ndërsa, në përgjigjeje të pyetjes së dytë, sa i përket sanksioneve, theksoi se nuk është fjala për sanksionet në raport me të punësuarit nga punëdhënësi, por për sanksionet ndaj shkelësve të të dhënave personale, dhe në rast, të shkeljes së këtyre të drejtave, këtë kompetencë për sanksionim ta ketë Agjencia dhe jo gjykata, me qëllim të efikasitetit.

Qerim Bajrami- Falënderoi të pranishmit, si dhe përfaqësuesit e këtij projekti. Më tutje, shtroi pyetjen si vijon: A ka praktika ku Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shqipton dënim për shkelësit dhe në çfarë mase bëhet kjo?

Nora Forgacs- Në përgjigjeje të z. Qerimi, theksoi se kjo çështje është e qartë, pasi është minimumi dhe maksimumi i vendosur nga Agjencia. Ndërsa, në koordinim me normat evropiane për këtë çështje, sa i përket minimumit dhe maksimumit, është çështje e marrëveshjes dhe qëllimi është që Agjencia të jetë kompetente për marrjen e masave dhe jo gjykata.

Kryesuesi- Falënderoi për prezantimin e bërë nga ana e përfaqësuesve të projektit.

4. Të ndryshme

Ganimete Musliu- Theksoi se në takimin e kaluar ka propozuar organizimin një vizitë në stacioni policor në veri të Mitrovicës. Deri ku ka ecur procesi, a është proceduar kjo vizitë?

Kryesuesi- Njoftoi se më datë 27 qershor do të realizohet kjo vizitë dhe se janë planifikuar të gjitha detajet e vizitës.

Nuredin Ibishi- Shtroi çështjen e anëtarësimit të institucioneve të Kosovës në nismat dhe organizatat e sigurisë, të Policisë së Kosovës dhe FSK-së. Për këtë arsye, propozoi që në njërin nga takimet e radhës, të ftohen zyrtarët kompetentë, që të njoftohet Komisioni për këtë çështje. Për këtë çështje mund të ftohen të raportojnë ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, komandanti i FSK-së, si dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Rexhep Selimi- Theksoi se pajtohet me propozimin e z. Ibishi, por ky propozim do të duhej të strukturohet dhe të ftohen kompetentët për çështjen e anëtarësimit të institucioneve të Kosovës në organizatat e sigurisë dhe propozoi që fillimisht të ftohet ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Nuredin Ibishi- Theksoi se janë disa nisma rajonale edhe në fushën e mbrojtjes, në të cilat mund të anëtarësohet edhe Kosova dhe propozoi që të ftohen zyrtarët përgjegjës për këtë çështje.

Rexhep Selimi- Shtoi se nëse do të ftohet ministri i Ministrisë së FSK-së dhe komandanti i Përgjithshëm i FSK-së, do të duhej që të njoftoni Komisionin, se deri ku kanë arritur në përgatitjen e infrastrukturës për transformimin e FSK-së, në Forca të Armatosura, dhe më pas, anëtarësimi në organizatat e sigurisë.

Kryesuesi- Theksoi se sa i përket ftesës në Komision të ministrit të Punëve të Brendshme, kjo ka qenë në agjendën e Komisionit, por për shkak të agjendës së ngjeshur të ministrit, nuk është realizuar, por në takimin e radhës, në përputhje edhe me agjendën e ministrit, do të ftohet në Komision, ku do të raportojë edhe për çështjen që propozoi z.Ibishi, si dhe për çështjen e sigurisë.

Ndërsa, sa i përket vizitës së planifikuar në veri të Mitrovicës, do të mbahet më datë 27 qershor dhe janë vendosur kontaktet me zyrtarët policorë në veri. Sa i përket vizitës në Leposaviq dhe në fshatin Sredskë, kjo do të shtyhet për një takim tjetër, për arsye të efikasitetit.

Më tutje, njoftoi Komisionin për vizitën e realizuar në Bruksel, nga data 20 deri më 22 qershor 2016, ku në këtë konferencë kanë marrë pjesë dy deputetë nga Kuvendi i Kosovës dhe përfaqësues i Komisionit ka qenë z. Demaku, po ashtu i ftuar ka qenë edhe z. Rexhep Selimi, por për arsye familjare nuk ka mundur të marrë pjesë. Tema e konferencës ka qenë: “Politikat e BE-së për azilin dhe emigracionin, implikimet e parlamenteve që aspirojnë BE-në”, ndërsa delegacioni nga Kosova ka paraqitur situatën aktuale dhe masat e ndërmarra nga shteti i Kosovës në këtë fushë.

Rexhep Selimi- Theksi se pavarësisht rrethanave politike, ka shprehur gatishmërinë të marrë pjesë në këtë konferencë, por për arsye familjare është dashur të kthehet nga aeroporti.

Nuredin Ibishi- Lidhur me pjesëmarrjen në konferenca, theksoi që do të duhej të jetë një pjesëmarrje më aktive nga ana e anëtarëve të Komisionit, pasi konsideroi që është i nevojshëm këmbimi i praktikave më të mira në sektorin e sigurisë.

Kryesuesi- Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Ibishi, shtoi se kjo çështje mund të ngrihet edhe në Kuvend dhe të jetë i njoftuar edhe Kryetari i Kuvendit, në mënyrë që mos të mbetet vetëm në nivel të Komisionit. Nëse nuk ka çështje të tjera, me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 11:05.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i parë i Komisionit,

Fadil Demaku